## Silabusi i lëndës: **Didaktikë e letërsisë**

| Informatat themelore për lëndën | |
|---|---|
| Njësia akademike: | Fakulteti i Filologjisë: Departamenti i gjuhës dhe i letërsisë gjermane |
| Titulli i lëndës: | Didaktikë e letërsisë |
| Niveli: | MA |
| Statusi i lëndës: | Me zgjedhje |
| Viti i studimeve: | Viti IV, semestri VIII |
| Numri i orëve në javë: | 2+0 |
| Kreditë ECTS: | 3 ECTS |
| Koha / Vendi: | |
| Mësimdhënësi: | Prof. dr. Naim Kryeziu |
| Të dhënat kontaktuese: | naim.kryeziu@uni-pr.edu |
| Përshkrimi i lëndës: | Synimi i "Didaktikës së letërsisë" është t'i njohë studentët me konceptet, me format dhe me metodat më të reja për studimin e mësimdhënies së kësaj lënde. Kërkesa parësore e lëndës në fjalë është që, gjatë këtij kursi, studentët të mësojnë e të përgatiten për të dhënë lëndën e letërsisë. Ky kurs u jep mundësi studentëve të njihen me përvojën e metodave didaktike që përqendrohen sidomos në teorinë dhe në praktikën e didaktikës së letërsisë. Studentët në këtë kurs fitojnë aftësi të reja metodiko-didaktike që janë të rëndësishme për perspektivën e tyre në mësimdhënie. Ata do të kenë mundësi t'i zbatojnë në praktikë njohuritë teorike të fituara në leksionet e kursit të kësaj lënde. |
| Qëllimet e lëndës: | Lënda "Didaktika e letërsisë" synon që studenti:<br>• të njihet me konceptet dhe me metodologjitë kryesore për lëndën e didaktikës së letërsisë.<br>• të zotërojë mënyrat më të rëndësishme për formimin e tij,<br>• të fitojë aftësi dhe mjeshtëri për organizimin e procesit mësimor,<br>• të zotërojë njohuritë bashkëkohore në fushën e mësimdhënies, |

| | |
|---|---|
| | të njohë teknikat e komunikimit dhe interpretimit në raportin mësimdhënës-student. |

| | |
|---|---|
| Rezultatet e pritshme të nxënies: | Pas përfundimit të këtij kursi, studenti duhet të ketë njohuri të mjaftueshme:<br>• për konceptet dhe për metodat në lëndën e didaktikës së letërsisë,<br>• për organizimin e mësimit,<br>• për aftësitë në të dëgjuar, në të shkruar dhe në të folur,<br>• për lëndën e didaktikës së letërsisë gjermane,<br>• për mjeshtërinë e zbatimit të metodave të mësimdhënies në lëndën e letërsisë, si dhe<br>• për interpretim e për komunikim. |

**Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)**

| Aktiviteti | Orë mësimore | Ditë/Javë | Gjithsej |
|---|---|---|---|
| Ligjëratat | 2 | 15 | 30 |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet | 45 min | 5 | 2.25 |
| Përgatitje për biseda ndërvepruese në lidhje me leksionet e zhvilluara | 15 min | 15 | 2.25 |
| Testi, punimi i seminarit | 2 | 11 | 22 |
| Detyrë shtëpie | 2 | 5 | 10 |
| Mësimi individual (në bibliotekë ose në shtëpi) | 2 | 5 | 10 |
| Përgatitja për provimin përfundimtar | 5 | 1 | 5 |
| Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi përfundimtar) | 1 | 1 | 1 |
| Projektet, prezantimet, etj. | 1 | 1 | 1 |
| Total | | | 83.5.25=3.34<br>3 ETCS |

| | |
|---|---|
| Format e mësimdhënies dhe të mësimnxënies: | Mësimi zhvillohet me ligjërata dhe me shpjegime përkatëse. Gjatë shpjegimeve zbatohet metoda ndërvepruese. Në fillim të ligjëratës zhvillohet gjithmonë debat për leksionin e mëparshëm. Në fund të ligjëratës bëhet një përsëritje e përbashkët e leksionit pasues. |
| Metodat e vlerësimit: | • Pjesëmarja aktive dhe detyrat 20 %<br>• Testi i parë 30 %<br>• Provimi përfundimtar (me shkrim/me gojë) 50% |
| Literatura primare: | 1. Literaturdidaktik, Prof. Dr. Mathias Kepser, Erich Schmidt Verlag GmbH, 2009<br>2. Einführung in die Literaturdidaktik , Verlag: Metzler, 2009, ISBN-13:978347613176<br>3. Grundsätze der Literaturdidaktik, Klaus Godal / Hermann Karte (Hgg.) ISBN-13:978342330987 |
| Literatura shtesë: | 1. Deutschdidaktik, Christiane Hochstadt, Andreas Krafft, Rolph Olsen, Verlag Utb, Francke, ISBN-13:973825240233 |

**Hartimi i planit mësimor**

| Java | Titulli i ligjëratës |
|---|---|
| Java 1: | Didaktika si shkencë |
| Java 2: | Didaktika e letërsisë |
| Java 3: | Teoria dhe praktika e didaktikës së letërsisë |
| Java 4: | Fushat e studimit të didaktikës së letërsisë |
| Java 5: | Metodat teoriko-didaktike të letërsisë |
| Java 6: | Bazat metodologjike të të mësuarit |
| Java 7: | Format kryesore të didaktikës të organizimit të procesit mësimor |
| Java 8: | Leximi, dëgjimi dhe kuptimi si proces i të nxënit |
| Java 9: | Interpretimi i letërsisë në procesin mësimor |
| Java 10: | Mënyrat e komunikimit mësimdhënës-student |
| Java 11: | Objektivat që duhet të realizohen gjatë procesit mësimor |
| Java 12: | Metodat, materialet dhe mjetet që duhen zbatuar në lëndën e didaktikës së letërsisë |
| Java 13: | Mësim ndërveprues në orët e letërsisë |

| | |
|---|---|
| Java 14: | Mësim  ndërveprues në orët e letërsisë |
| Java 15: | Këshillat praktike për mësimdhënie |

| **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes** |
|---|
| Studentët duhet të vijnë me kohë në auditor, sepse ardhja me vonesë sjell ndërprerjen e mësimit dhe pengon, çrregullon e shpërqendron vëmendjen e studentëve. Gjatë orës së mësimit nuk lejohet përdorimi i mjeteve elektronike, sepse shkaktojnë zhurmë ose pengesa të tjera. |

*Hartoi: Prof. dr. Naim Kryeziu/04.04.2025/NKr*